

AKT THEMELUES

I SHOQERISE TREGTARE PRIVATE

“Filara Education” SH.P.K.

Në bazë të Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007, “Për Qendrën Kombëtare e Biznesit” dhe të Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008, “Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare”, me vullnet të lirë, të shprehur në nënshkrimin e Aktit Themelues :

Znj. Ardita Cakaj, e bija Agimit, me ID: I66008061B lindur me, 08/10/1986, banues ne Tirane. Sot date 16/09/2021, Vendosa te krijoj shoqërine me pergjegjesi te kufizuar sipas kushteve të mëposhtme:

FORMIMI

NENI 1

Formohet shoqëria private e quajtur **“Filara Education”** sh.p.k. Shoqëria do ti nënshtrohet legjislacionit shqiptar, ndërsa degët që mund të krijohen do ti nënshtrohen legjislacionit ku do të ketë selinë dega.

Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj në bazë të këtij akti themelues dhe statutit të shoqërisë që do të miratohet nga ortakut themelues.

SELIA E SHOQERISE

NENI 2

Selia e shoqërisë tregtare private **“Filara Education”** sh.p.k. do të jetë : Rruga Maliq Muca, pall 46 shk1, ap1, Tirane.

Ajo mund te çelë dhe seli të tjera të dyta, degë e filiale, përfaqësi dhe agjenci operative në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, dhe me miratim të organeve kompetente edhe jashtë vendit.

Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra përfaqësie, dege, të krijojë filiale si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendimin e ortakeve themelues të saj.

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

NENI 3

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në fushën e:

1. Agjenci trajnimesh për zhvillimin e vazhduar profesional, trajnimin dhe çertifikimin e punonjësve arsimore.

NENI 4

Për kryerjen e veprimtarisë së saj shoqëria do të sigurojë mjetet e nevojshme dhe do të bashkëpunojë me persona fizikë dhe juridikë, vendas dhe të huaj.

KOHEZGJATJA E SHOQERISE

NENI 5

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë me një afat të pacaktuar. Ajo mund të shpërbëhet në çdo kohë dhe për çfarëdo lloj shkak.

KAPITALI I SHOQERISE

NENI 6

Kapitali themeltar i shoqërisë tregtare private **“Filara Education”** sh.p.k. do të jetë **100.000** (njqind mije) lekë, dhe do të përbëhet nga kuota e ortakut themelues të shoqërisë **Zj. Ardita Cakaj**.

Kapitali përbëhet nga 1 kuote dhe vlera nominale e një kuote është e barabartë me **100 000** lekë Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë mund të ndryshohet, të shtohet apo të pakësohet (por jo nën vlerën e kapitalit themeltar fillestar), sipas vendimit të ortakeve themelues të shoqërisë. Kapitali është tërësisht i shlyeshëm dhe i nënshkrueshëm

NENI 7

Ortaku i vetëm duhet të bëjë përpjekje për rritjen e potencialit ekonomik të shoqërisë, të ruajnë sekretin e saj dhe të mos dëmtojnë interesat e personave të tjerë dhe të shoqërisë.

DREJTIMI I SHOQERISE

NENI 8

Shoqëria do të drejtohet nga administrator, Zj. Ardita Cakaj, i cili është përfaqësues ligjor i saj. Afati i emërimit të administratorit është për një periudhë kohore prej **5** vjet me të drejtë ripërtëritje.

NENI 9

Të ardhurat neto të shoqërisë i takojnë ortakut themelues të shoqërisë.

NENI 10

Ortaku themelues ka të drejtë të emërojë dhe administratorë të tjerë të vlerave materiale të shoqërisë. Ata kanë të drejtë të caktojnë financiar, likuidator për problemet e shoqërisë, si edhe të pajtojnë persona të tjerë si ortakë. Financieri nxjerr rregullisht treguesit financiare tre-mujore, 6-mujore dhe vjetore, për aktivitetin e kryer të shoqërisë.

NENI 11

Konfliktet që mund të lindin midis palëve do të gjykohen dhe zgjidhen në zbatim të legjislacionit shqiptar në gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

NENI 12

Shoqëria ka vulën e saj në madhësi të zakonshme, me tekstin për rrethin e saj.

NENI 13

Shoqëria deklarohet e krijuar në zbatim të plotë të normave të statutit, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe veçanërisht të Ligjit **Nr. 9901** datë 14.04.2008, “ Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare ”.

NENI 14

Ky akt themelimi përpilohet në dy kopje me vlerë të barabartë, nga të cilat njëra depozitohet në Qendrën Kombëtare të Biznesit, njëra në zyrën e Tatimeve dhe kopja e tretë mbahet në dokumentat e shoqërisë tregtare "Filara Education" sh.p.k.

Akti i themelimit nënshkruhet rregullisht nga ortaku themelues.

ORTAKU THEMELUES I SHOQERISE

"Filara Education" sh.p.k

ARDITA CAKAJ

